



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.
Dep.		01-202/16
Nr. i faq.		Data
Broj. stranica	02	19-01-2016
Nr. pages		
PRISHTINE		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4287/15, për zyrtarin e lartë z. Mentor Ferizi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4287/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Mentor Ferizi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë, z. Mentor Ferizi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Mentor Ferizi, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët ngarkuar me rastin është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet si dhe me provat dhe faktet që posedon AKK-ja.

Zyrtari i lartë z. Ferizi, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme te konfliktit të interesit, pasi qe për këtë çështje nuk ka qen i njoftuar sepse do ti kishte ber me kohë ndryshimet.

Duke pare qe zyrtari nuk ka sjell asnjë dokument qe dëshmon që janë ber ndryshimet e kërkuara ne biznes i kemi dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese sipas nenit 18.5 e Ligjit Nr.04/L-051.

Me datën 15.01.2016, nga z. Mentor Ferizi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Mentor Ferizi nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin N.T.P “Delicious” me numër 71163253.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Mentor Ferizi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Vushtrisë, dukë ber ndryshimet ne biznesin privat dhe duke hequr dore nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar ne biznesin e tij, dhe duke e autorizuar një person tjetër si person te autorizuar ne këtë biznes, janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

